

Tiranë më, 13.07.2021

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“NORTH INTERNATIONAL HOLDING” SH.P.K

Emri shkurt i shoqerise “**N.I.H**”

Sot në date 13.07.2021, duke u bazuar në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar dhe në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, me vullnetin e tyre të lirë ortakët :

- **Z. GIORGIO VARANI**, i biri I Berlantino Varani dhe Iolanda Sette, lindur më 02/07/1961, në Cavarzere, ITALI dhe banues në Via Alessandro Volta n° 9 cod fiskal VRNGRG61L02C383M, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar , mbajtës I Pasaportes YB0065993.
- **Z.ALESSANDRO PALERMO**, i biri I Nerio Palermo dhe Vera Govoni, lindur më 18/07/1964 a Roma, Italia dhe banues në Rrugën “Via. Reggio Emilia RE Via Boiardi N 4,kod fiskal. PLRLSN64L18H501R”,madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportes YA4443179.

Ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi, nga ky Akt Themelimi dhe Statuti.

Neni 1 – Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë është **“NORTH INTERNATIONAL HOLDING” SH.P.K**

Emri shkurt i shoqerise “**N.I.H**”

Neni 2 – Selia

Selia e shoqërisë është në adresën TIRANE Njesia Bashkiake nr.9, Rruga e Barrikadave, Banesa tek ish Kinema 17 Nentori, (Galeria), Kati i trete, Zyra Nr.5

Neni 3 – Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë e pakufizuar.



Neni 4 – Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Ndërmjetësim për konsulence financiare, konsulence juridike.
- Import – Export mallrash.
- Shitje – Blerje të ndertesave dhe mallrash të ndryshme.
- Ndërmjetësim ndërkombëtar.
- Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

Neni 5 – Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë.
- Ky Kapital është tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga ortakët e shoqërisë **Z. GIORGIO VARANI**, në vlerën 90.000 (nëntëdhjetë mijë) lekë, përkatësisht 90% (nëntëdhjetë) përqind të kapitalit të shoqërisë, **Z. ALESSANDRO PALERMO**, në vlerën 10.000 (dhjetë mijë) lekë, përkatësisht 10% (dhjetë) përqind të kapitalit të shoqërisë. Shoqëria mund të shtojë ose pakësojë kapitalin e saj deri në limitin e përcaktuar me ligj, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.
- Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 kuota jo të barabarta.

Neni 6 – Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - Shitblerjes;
 - Trashëgimisë;
 - Dhurimit
 - Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj;
2. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm tek personat e tretë me miratimin e Asamblesë së Ortakëve.
3. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim;



Neni 7- Administratorët

Me këtë Akt emërohet Administrator i shoqërisë personi si më poshtë:

- **Z. GIORGIO VARANI**, i biri I Berlantino Varani dhe Iolanda Sette, lindur më 02/07/1961, në Cavarzere, ITALI dhe banues në Via Alessandro Volta n° 9 cod fiskal VRNGRG61L02C383M, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar , mbajtës I Kartës së Indetitetit YB0065993.

Neni 8 – Legjislacioni

Për sa nuk është shkruar në këtë Akt-Themelimi dhe Statut, do të bëhet në referim me dispozitat e legjislacionin tregtar në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 9 – Gjuha

Ky Akt Themelimi është i përbërë në 6 (gjashtë) kopje në gjuhën shqipe, që kanë vlerë të njëjtë ligjore.

ORTAKET E SHOQËRISË

“NORTH INTERNATIONAL HOLDING” SH.P.K


Z. GIORGIO VARANI
.....


Z. ALESSANDRO PALERMO
.....